

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 23.01.2021

Problemi 1

Bilanci vërtetues i Linda shpk, një kompani e përfshirë në sektorin e shitjes me shumicë, ka treguar se kishte një llogari pezull prej 10,616€ në kredi në fund të vitit më 31 dhjetor 2020. Gjatë shqyrtimit, janë identifikuar çështjet e mëposhtme:

(1) Për shkak të një problemi me softuer, blerjet me afat në shumë prej 4,864€ janë përfshirë në Llogaritë e Arkëtueshme në vend të Llogarive të Pagueshme.

(2) Më 1 dhjetor 2020, Linda shpk kishte marr një kredi afatgjatë (e ripagueshme në vitin 2025) në shumë prej € 240,000, me qëllim të blerjes së pasurive afatgjata në vitin 2021. Interesi në këtë kredi është 0.5% në muaj. Paga e parë është e pagueshme në Qershor 2021. Linda shpk ka bërë regjistrimet si në vijim për këtë kredi:

	€	€
Debi Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet	240,000	
Kredi Llogaritë e pagueshme		240,000

(3) Dividenda në shumë prej € 26,000 për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020, është deklaruar më 2 janar 2021 dhe paguar më 6 janar 2021. Ky është regjistrimi që është bërë për këtë transaksion:

	€	€
Debi Fitimi i mbajtur	26,000	
Kredi Banka		26,000

(4) Duhet të regjistrohet një faturë për shërbimet e auditimit në shumë prej € 7,500.

(5) Zbritjet e marra prej € 462 janë debituar në llogarinë e zbritjeve të lejuara si € 426, ndërsa konto tjetër është regjistruar saktë.

Kërkohet:

a) Përgatitni korrigjimet në ditar për këto transaksione për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020.

15 pikë

b) Përgatitni Llogarinë pezull për korrigjimet e bëra si më lartë.

5 pikë

Total 20 pikë

Zgjidhja e problemit 1

1) Regjistrimi i saktë

Debi Blerjet e mallit 4,864

Kredi Llogaritë e pagueshme 4,864

Regjistrimi i gabuar

Debi Blerjet e mallit 4,864

Debi Llogaritë e arkëtueshme 4,864

Kredi Llogaria pezull 9,728

Korrigjimi

Debi Llogaria pezull 9,728

Kredi Llogaritë e pagueshme 4,864

Kredi Llogaritë e arkëtueshme 4,864

2) Regjistrimi i saktë

Debi Paraja e gatshme (Banka) 240,000

Kredi Kredia afatgjatë 240,000

Debi Shpenzimet e interesit 1,200 ($240,000 \cdot 0.5\%$)

Kredi interesi i pagueshëm 1,200

Regjistrimi i gabuar

Debi Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet	240,000
Kredi Llogaritë e pagueshme	240,000

Korrigjimi:

Debi Paraja e gatshme (Banka) 240,000

Debi Llogaritë e pagueshme 240,000

Debi Shpenzimet e interesit 1,200

Kredi Kredia afatgjatë 240,000

Kredi interesi i pagueshëm 1,200

Kredi Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet 240,000

3) Regjistrimi i saktë

Nuk ka nevojë për regjistrim pasi qe deklarimi dhe pagesa janë bërë në Janar 2021

Regjistrimi i gabuar

Debi Fitimi i mbajtur 26,000

Kredi Banka 26,000

Korrigjimi

Debi Banka 26,000

Kredi Fitimi i mbajtur 26,000

4) Regjistrimi i saktë

Debi Shpenzimet për tarifat e auditimit 7,500

Kredi Të pagueshmet për auditimin 7,500

Regjistrimi i gabuar

Nuk ka

Korrigjimi

Debi Shpenzimet për tarifat e auditimit 7,500

Kredi Të pagueshmet për auditimin 7,500

5) Regjistrimi i saktë

Debi Llogaritë e pagueshme 462

Kredi Zbritjet e marra 462

Regjistrimi i gabuar

Debi Llogaritë e pagueshme 462

Debi Zbrierjet e lejuara 426

Kredi Llogaria pezull 888

Korrigjimi

Debi Llogaria pezull 888

Kredi Zbritjet e marra 462

Kredi Zbritjet e lejuara 426

Llogaria pezull		
	1) 9,728	S` 10,616
6)	888	
Saldo në fund 0		

Problemi 2

Dina shpk është kompani prodhuese dhe ka punësuar një praktikant të kontabilitetit. Ju si kontrollues financiar, u është kërkuar që të përgatitni regjistrimet e duhura në kontabilitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020.

- (1) Vlera neto në libra e ndërtesave më 1 janar 2020 ishte € 2,400,000. Kosto e ndërtesave ishte € 3,620,000.
- (2) Dina shpk ka blerë një ndërtesë në shumë prej € 450,000 më 1 mars 2020. Është vlerësuar se vlera e tregut e asaj ndërtese në atë datë ishte 500,000€.
- (3) Dina ka shitur një ndërtesë për € 800,000 më 31 dhjetor 2020 dhe e ka arkëtuar pagesën më 2 janar 2021, për shkak të festave të fundvitit. Kjo ndërtesë ishte blerë më 1 Janar 2006 për € 1,400,000. Për këtë transaksion është bërë regjistrimi si në vijim:

	€	€
Debi Banka	800,000	
Debi Shpenzimet e zhvlerësimit	16,000	
Kredi Patundshmëritë-Ndërtesat		816,000

- (4) Dina shpk ka rivlerësuar ndërtesat për herë të parë më 31 dhjetor 2020. Në këtë datë vlerësuesi professional ka raportuar se vlera e tregut e tyre është 2,000,000 €.
- (5) Politka e zhvlerësimit është si në vijim:
 - Ndërtesat: 2% metoda drejtvizore
 - Zhvlerësimi i pjesshëm nga data e blerjes në datën e shitjes

Kërkohet:

- a) Përgatitni kontot T për ndërtesat dhe tregoni se si duken shpalosjet për to në pasqyrat e vitit që përfundon më 31 dhjetor 2020.

10 pikë
- b) Bazuar në informatat si më lartë, përgatitni korrigjimet e duhura në ditar për transaksionet e vitit që përfundon më 31 dhjetor 2020.

10 pikë

Totali 20 pikë

Zgjidhja e problemit 2

a)

Kalkulimet-Shpalosjet

	<u>Ndërtesat</u>	<u>Totali</u>
Kosto	3,620,000	3,620,000
- Zhvlerësimi i akumuluar	(1,220,000)	(1,220,000)
VNL më 1 janar 2020	2,400,000	2,400,000
Shtesat	450,000	450,000
	2,850,000	2,850,000
Shitja - Kosto	(1,400,000)	(1,400,000)
Shitja - Zhvlerësimi i akumuluar	420,000	420,000
	1,870,000	1,870,000
Shp. e zhvlerësimit 2% metoda drejtvizore	(79,900)	(79,900)
	1,790,100	1,790,100
Rivlerësimi	209,900	209,900
VNL më 31 dhjetor 2020	<u>2,000,000</u>	<u>2,000,000</u>

Kalkulimi i zhvlerësimit

	Kosto	Zhvl 2%
Kosto më 1 janar 2020	3,620,000	72,400
Blerjet - 10 muaj zhvlerësim. 01.03.20 - 31.12.20	450,000	7,500
Gjithsej shpenzimet e zhvlerësimit për vitin		<u>79,900</u>
Shenimi 1		
Shitja ndodh më 31 dhjetor 2020, andaj pasuria zhvlerësohet për këtë vit.		

Ndërtesa-Kosto

S` 3,620,000	Shitja 1,400,000
Blerja 450,000	Rezerva e rivlerësimit 670,000
S`` 2,000,000	

Zhvlerësimi i akumuluar

Shitja 420,000	S`1,220,000
Rezerva e rivlerësimit 879,900	Shp.e zhvlerësimit 79,900
	S``0

b)

Blerja e ndërtesës

Debi Patundshmëritë, impijanetet e prodhimit dhe pajisjet	450,000
Kredi Paraja e gatshme	450,000

Korrigjimi i regjistrimit të gabuar të shitjes

Debi Patundshmëritë, impijanetet e prodhimit dhe pajisjet	816,000
Kredi Shpenzimet e zhvlerësimit	16,000
Kredi Paraja e gatshme (Banka)	800,000

Regjistrimi i shitjes

Debi Të arkëtueshmet për ndërtesat	800,000
Debi Humbja kapitale	180,000
Debi Zhvlerësimi i akumuluar	420,000
Kredi Ndërtesa me kosto	1,400,000

Kalkulimet:

Zhvlerësimi vjetor i ndërtesës së shitur: $= 2\% \times 1,400,000 = 28,000$

Zhvlerësimi i akumuluar për 15 vite $= 28,000 \times 15 = 420,000$
 $VNL = 1,400,000 - 420,000 = 980,000$

Humbja kapitale $= 980,000 - 800,000 = 180,000$

Regjistrimi i shpenzimeve të zhvlerësimit

Debi Shpenzimet e zhvlerësimit	79,900
Kredi Zhvlerësimi i akumuluar	79,900

Regjistrimi i rivlerësimit

Debi Zhvlerësimi i akumuluar 879,900

Kredi Ndërtesa-kosto 670,000

Kredi Rezerva e rivlerësimit 209,900

Problemi 3

Kompani Vesa shpk është një biznes i cili operon ne industrinë e hotelerisë dhe në fund të vitit kishte këto pasqyra financiare.

Vesa shpk-Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020

	€'000
Fitimi operativ	2,130
Të ardhurat nga interesi	126
Shpenzimet e financimit(interetit)	(387)
Fitimi para tatimit	1,869
Tatimi në te ardhura	<u>(341)</u>
Fitimi neto i vitit	1,528

Vesa shpk –Pasqyra e Pozitës Financiare 31 Dhjetor

	2020 €'000	2019 €'000
Pasuritë jo-qarkulluese		
Toka dhe makineritë	101,650	95,300
Prona investuese	15,000	19,625
Total pasuritë jo-qarkulluese	116,650	114,925
Stoqet	6,300	2,600
Llog.e Arkëtueshme	11,460	10,850
Paraja e gatshme edhe ekuivalentët	8,600	-
Total pas.qarkulluese	26,360	13,450
Total pasuritë	143,010	128,375
Ekuiteti		
Aksionet e zakonshme	48,000	40,000
Premia nga aks. e zakoshme	13,000	5,000
Aksionet preferenciale	2,600	2,600
Fitimet e mbajtura	3,573	2,595
Rezerva e rivlerësimit	21,540	18,300
Total Ekuiteti	88,713	68,495
Detyrimet afatgjata		
Kredia bankare	42,311	48,800
Total Detyrimet afatgjata	42,311	48,800
Detyrimet afatshkurta		
Llog e pagueshme	9,216	7,450
Overdrafti (mbitërheqja)	-	1,010
Akrualet	610	120
Tatimi i pagueshëm	2,160	2,500
Total detyrimet afatshkurta	11,986	11,080
Total Ekuiteti dhe detyrimet	143,010	128,375

Ndryshimet në ekuitet për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020

Total	Aksionet E zakonshme	Premia	Aksionet Preferenciale	Fitimet e mbajtura	Rezerva e Rivlerësimit	
	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000
Më 1 janar 2020	40,000	5,000	2,600	2,595	18,300	68,495
Emetimi i aksioneve	8,000	8,000				16,000
Dividenda – Preferenciale				(200)		(200)
Dividenda e zakonshme				(350)		(350)
Fitimi neto				1,528		
Rivlerësimi					3,240	
Më 31 Dhjetor 2020	48,000	13,000	2,600	3,573	21,540	88,713

Shënime:

i. Gjatë vitit Toka dhe Makineritë të cilat kishin kosto në vlerë 540,000 € ishin shitur për 240,000€. Ato pasuri ishin blerë gjatë vitit 2017. Venera shpk llogaritë zhvlerësimin me normë 10 % me metodën drejtvizore për komplet vitin e blerjes dhe nuk llogaritë në vitin e shitjes fare zhvlerësim .

ii. Shpenzimi i zhvlerësimit për Tokën dhe Makineritë në vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020 është 1,860,000 €.

iii. Pronat investuese ishin shitur pa fitim.

Kërkohet :

Përgatiteni Pasqyrën e rrjedhave të arkës së kompanisë Venera shpk për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020, duke u bazuar ne SNK 7 me metodën indirekte.

Zgjidhja e problemit 3

Pasqyra e rrjedhave të arkës së Vesa shpk për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020

Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative	'000	'000
Fitimi para tatimit		1,869
Korrigjimet për		
Të hyrat nga interesi	(126)	
Shpenz e zhvlerësimit	1,860	
Humbja nga shitja e tokës dhe makinerisë	138	
Shpenz. E interesit	387	4,128
Rritja në të Arkëtueshmet	(610)	
Rritja në stoqe	(3,700)	
Rritja në të pagueshmet	1,766	
Rritja në Akruale	490	
Paraja e gjeneruar nga operacionet		2,074
Interesi I paguar	(387)	
Interesi I pranuar	126	
Tatimi I paguar	(681)	
Paraja e gatshme nga A.operative		1,132
Paraja nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjen e Tokës dhe makinerisë	(5,348)	
Arkëtimet nga shitja e Tokës dhe makinerisë	240	
Arkëtimet nga shitja e pronës investuese	4,625	
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet investuese		(483)

Paraja nga aktivitetet financuese

Arketimet nga emetimi I aksioneve	16,000	
Pagesat për kredinë	(6,489)	
Dividend e paguar	(550)	
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		8,961
Rritja në P.e gatshme dhe ekuivalentët gjatë vitit		9,610

Paraja dhe ekuivalentët në fillim të vitit Shënimi 1 (1,010)

Paraja dhe ekuivalentët në fund të vitit Shënimi 1 8,600

Shënimi 1	2020	2019
	'000	'000

Paraja e gatshme 8,600 -

Overdrafti - (1,010)

Paraja dhe ekuivalentët 8,600 (1,010)

Shitja e tokës dhe makinerisë '000

Kosto	540
- Zhvlerësimi I akumuluar	- 162
VNL në datën e shitjes	378
Vlera e shitjes	240
Humbja nga shitja	(138)

Tatimi i pagueshëm

Tatimi I paguar 681	Saldo ' 2,500
	Shpenzimet 341
	S'' 2,841

Toka dhe makineritë(VNL)

Saldo ' 95,300	Zhvlerësimi 1,860
Rezerva e rivlerësimit 3,240	Pasuritë e shitura 378
<u>Blerjet e pasurive 5,348</u>	
Saldo "101,650	

Problemi 4

Pjesa 1)

Kompania Pakica para pak kohësh punësoi një kontabilist të ri. Kompania Pakica është një firmë e madhësisë së mesme për shitje me pakicë. Një nga detyrat e para për kontabilistin e ri ishte të bëjë konsolidimin bankar të muajit Qershor 2020. Në vazhdim janë informatat e raporteve bankare dhe regjistrimeve të kompanisë për muajin Qershor:

(10 pikë)

Depozitat në tranzit	7,200
Salldoja sipas raportit bankar	16,500
Ngarkesa për shërbimet bankare	30
Çeçet e papaguara	9,750
Pagesat e paregjistruara	3,000
Depoziti prej 3,300 është regjistruar gabimisht në kompani(librin e arkës) si	3,030

Kërkohet:

- Me supozimin se informacionet e lartë shënuara janë të sakta dhe komplete, bëni konsolidimin bankar për muajin Qershor 2020.
- Sa është shuma e **pakorrigjuar** e librit të arkës?

Pjesa 2)

Kompania E-Digi në fillim të biznesit të vet ka pasur këto saldo në llogari më 1 janar 2020: Llogaritë e Arkëtueshme 1,240,000€ dhe saldo kreditore të lejimeve për borxhet e dyshimta 36,000€. Gjatë vitit 2020, shitjet me kredi ishin në total 5,190,000€ dhe paraja e gatshme e inkasuar nga konsumatorët ishte 5,380,000€. Gjithashtu llogaritë e arkëtueshme të shlyera në vitin 2020 ishin 33,000€. Në fund të vitit, pasqyra e moshimit të llogarive të arkëtueshme paraqet saldon në llogarinë e lejimeve për borxhet e dyshimta prej 32,300€. Nuk janë arkëtuar asnjë nga llogaritë e arkëtueshme të shlyera më herët.

(10 pikë)

Kërkohet:

- Përcaktoni saldon e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe tregoni se si do të paraqiten LL/ A Neto në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në këtë datë.
- Bëni hyrjet për të regjistruar shlyerjen e llogarive të arkëtueshme gjatë vitit dhe hyrjen korrigjuese në fund të vitit për t'i regjistruar shpenzimet e borxheve të këqija.

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

Pjesa 1)

a.

<i>Konsolidimi Bankar</i>				
Qershor, 30				
	<i>Banka</i>		<i>Libri i Arkës</i>	
Saldo , 30, Qershor	16,500		?	
Depozitat në tranzit	7,200			
Qeqet e Pa paguara	(9,750)			
Gabimi në arkë			270	
Pagesat e paregjistruara			(3,000)	
Shpenzimet bankare			(30)	
Saldo e korrigjuar	<u>13,950</u>		<u>13,950</u>	

a.

b. Arka në fillim 16,710.

Pjesa 2)

1.

Saldo fillestare	€1,240,000
Plus : shitjet me kredi	5,190,000
Minus : arkëtimi i parave të gatshme	(5,380,000)
Shlyerja e borxhit te keq	<u>(33,000)</u>
Saldo përfundimtare	<u>€1,017,000</u>
Ekstrakt nga PPF	
Pasurite	
LL/ A	€1,017,000
Lejimet me 31/12(32,300)	
<u>LL/A Neto</u>	<u>984,700</u>

2.

Për të regjistruar shlyerjen e llogarive të arkëtueshme:

Shpenzimet e borxheve te keqija	33,000	
Llogaritë e arkëtueshme		33,000

Lejimet per borxhet e dyshimta

	S'36,000
Te hyrat nga b.d (Shifer balancuese) 3,700	
	S''32300

Për të regjistruar borxhet e dyshimta

Debi Lejimet per borxhet e dyshimta	3,700	
Kredi Te hyrat nga borxhet e dyshimta		3,700

Problemi 5

Mali shpk, një kompani me përgjegjësi të kufizuar, ka vitin kontabël që përfundon më 31 tetor. Kontabilisti është duke përgatitur pasqyrat financiare më 31 tetor 2020 dhe ka kërkuar ndihmën tuaj. Bilanci Vërtetues në vijim është nxjerrë nga libri kryesor.

<i>Kontot</i>	<i>Debi</i> €'000	<i>Kredi</i> €'000
Ndërtesat me kosto	740	
Zhvlerësimi i akumuluar për ndërtesat 01 nëntor 2019		60
Fabrika me kosto	220	
Zhvlerësimi i akumuluar për fabrikën 01 nëntor 2019		110
Overdrafti bankar		70
Të hyrat		1,800
Blerjet neto	1,140	
Stoqet më 01 nëntor 2019	160	
Paraja e gatshme	20	
Llogaritë e pagueshme		250
Llogaritë e arkëtueshme	320	
Shpenzimet administrative	325	
Lejimet për llogaritë e arkëtueshme më 01 nëntor 2019		10
Fitimet e mbajtura më 01 nëntor 2019		130
Aksionet e zakonshme (1€)		415
Premia		80
	2,925	2,925

Informatat shitesë në vijim janë në dispozicion:

- Lejimet për të arkëtueshmet janë rritur në 5% për llogaritë e arkëtueshme. Shpenzimet në lidhje me to trajtohen si shpenzime administrative.
- Fabrika zhvlerësohet me 20% në vit duke përdorur metodën e saldoshmërisë dhe ndërtesat zhvlerësohen me 5% në vit duke mbi koston e tyre origjinale.
- Stoqet në fund janë numëruar dhe kanë vlerë prej 75,000€.
- Një faturë prej 15,000€ për shpenzimet e energjisë elektrike në lidhje me tremujorin që përfundon më 30 nëntor 2020 ishte pranuar më 02 dhjetor 2020. Shpenzimet e energjisë elektrike duhet të përfshihen në shpenzimet administrative.

Kërkohet

Përgatitni pasqyrën e të ardhurave dhe të pozicionit financiar për Mali shpk më 31 tetor 2020.

[20 pikë]

Zgjidhja e problemit 5

MALI SH.P.K.

PASQYRA E TË ARDHURAVE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 TETOR 2020

	€'000
Të hyrat	1,800
Kosto e shitjes (llog.1)	(1,225)
Fitimi bruto	575
Shpenzimet administrative (325 + 10 (llog.4) + (6 (llog.3))	(341)
Shp.e zhvelresimit	(59)
Fitimi për vitin	175

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 TETOR 2020

	€'000	€'000
<i>Pasuritë</i>		
Pasuritë jo-qarkulluese (llog.2)		731
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	75	
Llogaritë e arkëtueshme (llog.3)	304	
Paraja e gatshme	20	
		399
Total Pasuritë		1,130
Ekuiteti dhe detyrimet		
Ekuiteti		
Aksionet e zakonshme	415	
Fitimet e mbajtura (130 + 175)	305	
Premia	80	
		800
Detyrimet afatshkurtra		
Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme tjera (250 + 10 (llog.4))	260	
Overdrafti bankar	70	
		330
		1,130

Llogaritja 1: Kosto e shitjes

	€'000
Stoqet në fillim	160
Blerjet	1,140
Stoqet në fund	(75)
	1,225

Llogaritja 2: Pasuritë jo-qarkulluese

	<i>Ndërtesa</i>	<i>Fabrika</i>	<i>Total</i>
	€'000	€'000	€'000
Kosto	740	220	960
Zhvlerësimi S'	(60)	(110)	(170)
Zhvlerësimi për vitin			
740 × 5%	(37)		
(220 – 110) × 20%		(22)	(59)
VNL 31 tetor 2020	<u>643</u>	<u>88</u>	<u>731</u>

Llogaritja 3: Llogaritë e arkëtueshme

Lejimet = 320,000 × 5% = 16,000

16,000-10,000=6,000-shpenzime

320,000 – 16,000 = 304,000

Llogaritja 4: Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshmet tjera

Akruali i shpenzimeve të energjisë elektrike: 15,000 × 2/3 = 10,000